


# DEMOKRACIA NË ZEMRAT TONA



## TI VENDOS PËR TË ARDHMEN

VLERA (11), VESA (11), ALBA (11), RINA (11), ERONA (11), BENET (12), ISA (11), ELONA (13)

NGADHNJIM (11)



### **Qytetar të dashur, nga ne sot do të mësoni se pse është e rëndësishme të jetojmë në një shtet demokratik**

Demokracia është qeverisje e popullit. Në demokraci mendimi i secilit prej nesh ka vlerë të madhe. Të jetosh në demokraci do të thotë të jetosh në liri dhe në paqe. Demokracia për herë të parë është shfaqur në Athinë në vitin 507 para erës sonë. Për dallim nga sot, atëherë nuk kishte demokraci të plotë sepse të drejtë vote kishin vetëm burrat dhe të pasurit. Kurse gratë dhe të varfërit nuk e kishin të drejtën e votës. Por, duke e dhënë secili kontributin e vet, kemi arritur që të kemi demokraci më të plotë në kuptimin e asaj që të gjithë i kemi të drejtat e barabarta dhe të gjithë e kemi të drejtën e votës.

Në demokraci bëjnë pjesë disa elemente të rëndësishme, të cilat janë: liria, paqja, respekti, solidariteti, barazia, drejtësia, ndarja e pushtetit, edukata, tole-

ranca, mendimi i lirë, sovraniteti, të drejtat, etj. Nëse këto elemente zbatohen me përpikmëri, shteti ynë do të funksionojë shumë më mirë. Prandaj duhet që të gjithë të jemi qytetarë aktiv në mënyrë që ta ndërtojmë edhe më shumë demokracinë.

Dy llojet më të njohura të demokracisë janë: demokracia përfaqësuese dhe demokracia e drejtpërdrejtë. Demokracia përfaqësuese ndahet në dy sisteme: sistemi parlamentar dhe sistemi presidencial. Shteti ynë Kosova, ka demokraci përfaqësuese parlamentare, ku populli del dhe voton duke i zgjedhur kështu 120 deputetët të cilët i përfaqësojnë interesat e popullit në Kuvend. Aty miratohen ligje shumë të rëndësishme për jetën tonë, për shembull ligjet për arsim, shëndetësi, infrastrukturë, etj.

Mos harroni se të gjithë ne jemi të ndryshëm por duhet të jemi të bashkuar, sepse mirëkuptimi bën që ne të jemi të gjithë të barabartë.



Barazia element themelor i demokracisë



Gazetarët e demokracisë



# NE VOTOJMË ÇDO DITË

ENSAR (11), DITJONA (12), RINESA (12), MEDINA (11), ARIANIT (11), BRIKENA (11), ERIS (11), HANA (12)

ENITA (11)

## Në jetën e përditshme përballemi me zgjedhje të ndryshme

Demokraci quajmë qeverisjen e lirë të çdo qytetari. Në demokraci çdo njeri ka të drejtën e shprehjes dhe të lirisë. Përveç këtyre të drejtave, kanë të drejtën e zgjedhjes së lirë. Për sa i përket fëmijëve ata nuk kanë të drejtë të votojnë për kryetar të komunës apo kandidatë për deputet deri në moshën 18 vjeçare. Megjithatë, në përditëshmëri, fëmijët kanë mundësi të votojnë, si p.sh. për kryetar, sekretar dhe arkatar të klasës, poashtu të zgjedhin lojën e preferuar, të zgjedhin veshjen e preferuar, etj. Të zgjedhurit e popullit, pra deputetët kanë mandat katër vjeçarë, por nëse ata përmbushin premtimet e tyre, populli me anë të votës mund t'iu vazhdoj mandatin edhe për katër vjet të tjera. Ne jemi të lumtur që kemi mundësi t'i shprehim mendimet tona dhe kemi mundësi zgjedhjeje çdo ditë.




Gazetarët e demokracisë



Gazetarët gjatë mbledhjes



Të drejtat e barabarta



Basketbollisti Xhon




Një qytetare duke votuar






Punëtoritë e Demokracisë „Demos-ti“



Ulësja e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës



Partenoni shumë ngjyrësh



Paqe për të gjithë



Vendos ti, duke votuar



Numri i deputetëve në Kuvendin e Kosovës




Pa dallim race, feje apo kombësie



Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës

# FUNKSIONET E KUVENDIT TË KOSOVËS

FIGURELA (11), RINESA (12), VLERË (11), ALBINA (11), GENTI (12), RESA (12), AMILA (11), ANESA (12), ANDA (11)



## Se sa e rëndësishme është të dijmë për Kuvendin, lexoni artikullin tonë për t'u informuar

Kuvendi është institucioni më i lartë shtetëror dhe ka rëndësi shumë të madhe. Po pse është kaq i rëndësishëm? Rëndësia e këtij institucioni vjen nga vet funksionet që ai kryen. Ndër funksionet më të rëndësishmet janë: funksioni përfaqësues, funksioni legjislativ dhe funksioni kontrollues.

Funksioni përfaqësues: deputetët e shtetit të Kosovës kanë për detyrë të na përfaqësojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Njëllot sikurse ne, që sot kemi marrë një detyrë apo thjeshtë një përgjegjësi për të qenë gazetarë brenda katër orëve. Padyshim që edhe kjo është një përgjegjësi të cilën ne duhet ta kryejmë me shumë vullnet, përkushtim dhe përpikmëri.

Funksioni legjislativ: sikurse funksioni përfaqësues edhe ky funksion kryhet nga vet deputetët tanë, të cilët e kryjnë këtë funksion me shumë vullnet dhe vetëbesim. Ligjet që ata i miratojnë janë në interesin tonë si qytetarë të cilët janë votuar, votohen dhe do të vazhdojnë të votohen.

Funksioni kontrollues: sikurse deputetët të cilët kanë të drejtën e votimit edhe ne si nxënës shprehim votat tona për zgjedhjen e kryesisë së klasës. Të gjithë deputetët duke përfshirë edhe qytetarët votojnë në tri mënyra: në mënyrë të mbyllur me fletëvotime, në mënyrë të hapur me ngritje dore dhe në mënyrë digjitale. Kjo është krejt sa i përket Kuvendit dhe rëndësisë së tij. Si porosi e jona është se ne çdo herë duhet të kemi

respekt ndaj njëri-tjetrit dhe të jemi të përgjegjshëm në punët që i kryejmë.



Deputetja Anda duke dhënë idenë për një projektligj



Deputetët e ardhshëm





## IMPRESUM

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:  
Tel: +381 38 704 560  
E-mail: [info@demos-ti.org](mailto:info@demos-ti.org)  
Website: [www.demos-ti.org](http://www.demos-ti.org)

Pjesëmarrësit:  
SHFMU „Zenel Hajdini“  
Klasa: VI-7  
Vendi: Prishtinë